



UNIVERSITETI
BARLETI

STATUTI I UNIVERSITETIT "BARLETI"



**STATUTI I UNIVERSITETIT
BARLETI**

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

1. Institucioni jopublik i arsimit të lartë **Universiteti “Barleti”**, i quajtur në vijim **UniBa**, ushtron aktivitetin tij bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Emri i institucionit në gjuhën angleze është **Barleti University**.
3. **UniBa** është licencuar me vendim nr. 571, datë 12.08.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, “Universiteti “Marin Barleti” dhe kryen veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Selia kryesore e **UniBa** ndodhet në adresën: “Rruga Frang Bardhi”, Selitë, Tiranë.

Neni 2

Forma

Bazuar në specifikimet e pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, **UniBa** është person juridik privat, në pronësi të shoqërisë tregtare **BARLETI Group**, themeluar me vendimin nr. **32511**, datë **06.12.2004** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me numër identifikimi **K52115006H**.

Neni 3

Parimet Bazë

1. **UniBa** është institucion laik, i depolitizuar dhe i pavarur.
2. Ai zhvillon aktivitetin e tij bazuar në respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor, kërkimor - inovativ dhe në krijimtari e programe të ndryshme zhvillimore në kuptimin që shpreh ligji i arsimit të lartë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Veprimtaria e **UniBa** me studentët dhe personelin mbështetet në meritat personale dhe përjashton çfarëdo lloj diskriminimi.

Neni 4

Misioni

UniBa ka për mision që të përgatisë studentet si profesioniste novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes, si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm.

Neni 5**Vizioni**

1. Vizioni i **UniBa** është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor si një aktor i zhvillimit, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatisë individë të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv.
2. Për të realizuar vizionin e tij **UniBa** synon të bëhet një institucion inovativ dhe lider, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës, duke vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.

Neni 6**Shtyllat Kryesore**

Aktiviteti i **UniBa** mbështetet në këto shtylla kryesore:

- a) **Shtylla Akademike** e fokusuar në strukturën dhe ofertën akademike.
- b) **Shtylla e Studentit në Qendër** e fokusuar në veprimtaritë studentore dhe komunitare.
- c) **Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit**, fokusuar në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuara, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme si drejtësia, qeverisja, ekonomia, tregtia, industria, teknologjia, informatika, energjetika etj.
- d) **Shtylla Korporative dhe Administrative**, fokusuar në veprimtaritë me karakter administrativ.
- e) **Shtylla e Sipërmarrjes**, fokusuar në veprimtaritë e sipërmarrjeve të ngritura nga ana e institucionit, me qëllim përmbushjen e misionit të tij.

Neni 7**Qëllimi**

1. **UniBa** ka për qëllim të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme dhe në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve EQF dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve KSHK, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimin, për të përgatitur teknikë, specialistë dhe ekspertë të mirëformuar.
2. **UniBa** ka për qëllim të zhvillojë programe formuese dhe trajnuese si dhe të realizojë shërbime arsimore, sociale dhe kulturore në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare.
3. Në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, ai ka për qëllim të ofrojë programe studimi afatshkurtra për kualifikime e specializime, si dhe për përditësimin e dijeve të fituara.
4. Për përmbushjen e qëllimit të tij, **UniBa** mund të kontraktohet, bashkëpunojë e të lidhë marrëveshje me ente publike e private për veprimtari të përbashkëta didaktike, të praktikave mësimore, kërkimit dhe konsulencës e shërbimeve ndaj të tretëve.
5. **UniBa** ka për qëllim të realizojë projekte të ndryshme zhvillimi të cilat mund të fokusohen në ndërtim, rikonstrukcion apo pajisje të infrastrukturës së nevojshme, laboratorëve, auditorëve apo godinave dhe territoreve të caktuara në shërbim të procesit akademik, rekreacionit, aktivitetit sportiv apo të jetës së studentëve, stafit dhe qytetit ku zhvillojnë aktivitetin.

Neni 8**Të drejtat e institucionit**

UniBa ka të drejtë:

- a) Të vendosë për programet e studimi që do të ofrojë, në përputhje me normat përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, **UniBa** ka të drejtë të miratojë strukturat, planet dhe programet e veta mësimore dhe të kërkimit shkencor, tekstet, manualët dhe leksionet për përdorim nga ana e studentëve të tij.
- b) Të për zgjedhë personelin akademik, personelin administrativ dhe atë ndihmës dhe të kërkojë prej personelit të punësuar respektimin e përgjegjësiave përkatëse.
- c) Të përcaktojë kritere për pranimin dhe për zgjedhjen e studentëve që regjistrohen në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe me aktet e brendshme të **UniBa**.
- d) Të lidhë marrëveshje me Asamblenë e Ortakëve në lidhje me përdorimin e aseteve të zotëruara nga shoqëria në përputhje me misionin e tyre.
- e) Të anëtarësohet në shoqata e organizata universitare kombëtare dhe ndërkombëtare, të krijojë lidhje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.
- f) Të vendosë bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme publike dhe private, industri prodhuese apo dhe operatorë biznesi për të pasur një ndërveprim proaktiv me tregun e punës.
- g) Të krijojë organizata jofitimprurëse në funksion të qëllimit të tij.
- h) Të disponojë të gjitha të drejtat mbi pronësinë intelektuale, të dhuruara ose të fituara në emër të tij.

Neni 9**Detyrimet e institucionit**

UniBa ka detyrimin:

- a) Të mundësojë zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe normave dhe standardeve ndërkombëtare;
- b) T'i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe të akreditimit institucional si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron;
- c) Të bëjë publike programet e studimit që ofron;
- d) Të bëjë publike kriteret për regjistrimin dhe ndjekjen e studimeve universitare në të gjitha ciklet e studimit në institucion;
- e) Të respektojë angazhimet e tij që rrjedhin nga kontratat me studentët dhe personelin e punësuar pranë tij;
- f) Të zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 10**Sigurimi i Cilësisë**

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë së **UniBa**.
2. **UniBa** harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Kodin e Cilësisë dhe praktikatat më të mira bashkëkohore.
3. Sigurimi i Cilësisë në **UniBa** realizohet nëpërmjet Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC).
4. NJZHKC përbehet nga:
 - a) Drejtuesi i Njësisë;
 - b) Koordinatori për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor;
 - c) Koordinatori për procesin e vlerësimit të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave;
 - d) Koordinatori për sigurimin e standardeve dhe ndjekjen e proceseve të akreditimit.
5. Ndër funksionet kryesore të NJZHKC janë:
 - a) Vlerësimi periodikisht i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.
 - b) Organizimi në fund të çdo semestri i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
 - c) Realizimi i studimeve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga UniBa. Ky proces realizohet në bashkëpunim me Zyrën Alumni dhe Departamentet përkatëse. Në përfundim të tij NJZHKC paraqet në njësitë bazë dhe kryesore të institucionit gjetjet përkatëse me qëllim përdorimin e tyre në përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulave.
 - d) Propozimi i ndryshimeve në funksion të garantimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe aktet nënligjore.
 - e) Hartimi i standardeve dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë që zbatohen në UniBa, në përputhje me Kodin e Cilësisë.
 - f) Ndjekja dhe koordinimi i proceseve të akreditimit në bashkëpunim me njësitë e tjera institucionale.
6. Këto dhe funksione të tjera të Njësisë rregullohen në mënyrë të detajuar në Rregulloren e UniBa.
7. Për sigurimin e jashtëm të cilësisë, **UniBa** mbështetur në legjislacionin në fuqi, i nënshtrohet vlerësimit institucional dhe atij të programeve të studimit që ofron.

Neni 11

Përfaqësimi juridik

Si person juridik, **UniBa** përfaqësohet nga Rektori dhe/ose nga Administratori, sipas rastit.



KREU II

STRUKTURA E UNIVERSITETIT “BARLETI”

Neni 12

Njësitë Përbërëse

UniBa përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmëse-akademike dhe njësi administrative, bazuar në legjislacionin në fuqi, paraqitur në organogramën bashkëlidhur këtij statuti.

Neni 13

Fakultetet

1. Fakultetet e **UniBa** janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofrojnë programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përfundim të të cilave lëshohen diplomat përkatëse.
2. Struktura e Fakulteteve, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tyre përcaktohen në këtë Statut dhe në aktet e tjera normative të **UniBa**.
3. Fakultetet në **UniBa**, përbëhen nga njësitë bazë të institucionit të cilat janë departamentet dhe qendrat kërkimore shkencore.

Neni 14

Institutet dhe Qendrat Kërkimore-Shkencore

1. **UniBa** rezervon të drejtën për të ngritur institute si njësi kryesore dhe qendra kërkimore-shkencore si njësi bazë të institucionit, të cilat do të kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore, konsulence, aplikimi projektsh dhe programesh të zhvillimit dhe inovacionit.
2. Institutet dhe qendrat kërkimore-shkencore do të funksionojnë mbi bazën e akteve normative përkatëse të **UniBa**, akteve specifike të themelimit, rregulloreve përkatëse dhe legjislacionit në fuqi. Drejtuesit e tyre do të emërohen në bazë të akteve normative të brendshme të institucionit dhe qendrës apo institutit përkatës.
3. Qendrat, mund të mbështesin realizimin e programit të studimeve të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.
4. Pranë fakulteteve mund të ngrihen dhe të funksionojnë qendra kërkimore-shkencore. Fushat e kërkimit të qendrave janë komplementare ose zgjerojnë ose ndërlidhin interesat e departamenteve me fusha të tjera interesi.
5. **UniBa** rezervon të drejtën për të ngritur Qendra Aplikative dhe Prodhuese, në të cilat studentë, pedagogë apo profesionistë të fushave të ndryshme të kenë mundësinë të zhvillojnë aktivitete praktike / aplikative në zbatim të njohurive shkencore si për shembull prodhimin e kampioneve të produkteve të ndryshme, zhvillimin e testeve të natyrave të ndryshme, krijimi e maketeve të projekteve arkitekturore si dhe procese të tjera të kësaj natyre, në fusha të ndryshme shkencore.



Neni 15

Departamentet

1. Departamentet, si njësi bazë të institucionit, mundësojnë zhvillimin e mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit. Ato përfshijnë fusha kërkimi të përafërta apo komplementare dhe grupojnë disiplinat mësimore përkatëse. Departamentet janë përgjegjës për programet e studimit që ofrojnë.
2. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimeve të akteve normative të brendshme të **UniBa**.
3. Detyrat dhe funksionet e Departamenteve, si dhe numri dhe cilësitë e anëtarëve të tij përcaktohen në mënyrë të detajuar në aktet normative të institucionit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili emërohet nga Rektori.

Neni 16

Njësitë Ndihmëse

Në përbërje të **UniBa** zënë vend edhe njësi ndihmëse dhe administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njësi ndihmëse konsiderohen njësitë e bazave prodhuese, laboratorët, njësia e botimeve akademike e njohur si “Barleti Press”, biblioteka, palestrat, njësitë didaktike e të tjera, të cilat shërbejnë në zhvillimin e procesit akademik, kërkimor dhe praktik si dhe çdo njësi tjetër me qëllim realizimin e misionit të institucionit si dhe planit zhvillimor-strategjik.

Neni 17

Njësitë Administrative

Njësitë kryesore administrative në **UniBa** janë Asambleja e Ortakëve, Bordi i Administrimit dhe Zyra e Administratorit, të cilët asistohen nga administrata, organizimi i së cilës është i rregulluar në aktet përkatëse normative të institucionit.

Neni 18

(shfuqizohet)

KREU III

ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I UNIVERSITETIT “BARLETI”

Neni 19

Organet dhe Autoritetet Drejtuese të UniBa

Struktura drejtuese e **UniBa** përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, si dhe nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative, si më poshtë vijon:

- a) Organi më i lartë drejtues akademik është **Senati Akademik**. Organe të tjera akademike janë **asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme**.



- b) Autoritetet drejtuese akademike janë: **Rektori** si autoriteti më i lartë drejtues akademik, **Drejtuesit e njësive kryesore (Fakultetit, Institutit)** dhe **Përgjegjësit e njësive bazë (Departamentit, Qendrës)**.
- c) Organi më i lartë administrativ dhe menaxherial është **Bordi i Administrimit**.
- d) Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore. Autoritet administrativ është administratori i njësisë bazë.
- e) Organe kolegjiale të tjera janë Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta, Komisioni i Vlerësimit të Performancës.
- f) **UniBa** rezervon të drejtën për të krijuar në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera drejtuese, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit dhe me legjislacionin në fuqi.

Seksioni 1

ORGANET DREJTUESE AKADEMIKE

Neni 20

Senati Akademik

1. Senati Akademik është organi kolegjial më i lartë akademik i **UniBa**, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij. Ai ka kompetencën të vendosë në lidhje me çështjet më të rëndësishme të procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe kompetenca të tjera të përcaktuara në këtë Statut dhe në aktet e tjera normative të institucionit.
2. Senati përbëhet nga 19 anëtarë:
 - a) rektori;
 - b) zëvendësrektorët;
 - c) katër drejtuesit e fakulteteve;
 - d) një student për çdo fakultet, i zgjedhur nga vetë studentët e fakultetit përkatës;
 - e) anëtarët e tjerë të senatit akademik të UniBa, të cilët përfaqësojnë në mënyrë proporcionale fakultetet, zgjidhen nga asamblatë e personelit akademik të tyre, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata duhen të jenë personel akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar ose të propozuar. Lista e kandidateve fitues nga asambleja e personelit akademik të fakulteteve i dërgohet për miratim senatit akademik.
3. Anëtarët e Senatit të cilët janë staf akademik, i përkasin kategorisë profesor ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose BE. Në mungesë të personelit akademik të sipërpërmendur, mund të kandidojnë edhe anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, por janë lektorë dhe mbajnë gradën “Doktor”.
- 3/1. Kur krijohen vende vakant për anëtar të senatit akademik, rektori thërret zgjedhjet në njësinë përkatëse.
4. Anëtarët e Senatit që zgjidhen nga studentët, kanë një mandat dy vjeçar, ndërsa të tjerët kanë një mandat katër vjeçar.



5. Senati mbledhet rregullisht një herë në dy muaj me nismë të Rektorit. Ai mund të mbledhet gjithashtu edhe në seanca të jashtëzakonshme me thirrjen e Rektorit ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve.
6. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Senatit është pjesëmarrja e 2/3 e të anëtarëve të tij. Në rast se nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, Rektori vendos një datë tjetër për zhvillimin e mbledhjes jo më vonë se dhjetë ditë.
7. Senati Akademik merr vendime me konsensus dhe kur kjo nuk arrihet, merr vendime me shumicë të thjeshtë votash, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut. Vendimet e tij Senati i bën të njohura nëpërmjet Rektorit.
8. Mandati i anëtarit të senatit akademik mbaron:
 - me mbarimin e afatit katër vjeçar;
 - me dorëheqje;
 - kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UniBa;
 - kur mungon pa arsye në 4 seanca radhazi mbledhjesh të tij.

Neni 21

Funksionet e Senatit Akademik

Senati Akademik i **UniBa**:

- a) garanton autonominë e këtij institucioni, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
- b) propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
- c) miraton Statutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
- ç) harton strukturën e përgjithshme të institucionit dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
- d) miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera normative, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Statut dhe legjislacionit në fuqi;
- e) miraton planet mësimore dhe ato kërkimore shkencore, programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre;
- ë) përcakton normat vjetore të ngarkesës mësimore shkencore për personelin akademik;
- f) propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- g) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, pasi merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
- gj) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
- h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektori, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- i) miraton kriteret arsimore dhe të kualifikimit për angazhimin e personelit akademik;
- j) i propozon Rektorit kërkesat buxhetore për vitin pasardhës në përputhje me Strategjinë e zhvillimit afatmesëm;
- k) vendos për krijimin e komisioneve të përcaktuara në këtë Statut;
- l) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion;



- m) krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- n) organizon mbledhjen e përbashkët me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, me qëllim analizimin e performancës vjetore;
- nj) miraton politikën për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të institucionit dhe shfrytëzimit ekonomik të saj.

Neni 22

Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik të **UniBa** është organ kolegjal dhe përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësive kryesore:
 - a) Zgjedh dy përfaqësues nga çdo njësi kryesore si anëtarë të Senatit Akademik;
 - b) Vendos për krijimin e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore përkatëse dhe zgjedh anëtarët e tyre.

Neni 23

Komisionet e përhershme

1. Në **UniBa** krijohen dhe funksionojnë komisionet e përhershme, të cilat janë organe kolegiale që veprojnë në përputhje me misionin e institucionit dhe mbulojnë:
 - a) kualifikimin shkencor;
 - b) garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit;
 - c) mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit dhe marrëdhëniet me studentët.
2. Komisionet e përhershme mund të krijohen në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Ato përbëhen nga jo më pak se pesë anëtarë dhe në përbërje të tyre mund të ketë edhe një student.
3. Anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit vetë kandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Institucioni rezervon të drejtën për të rishikuar procedurën e zgjedhjes së tyre.
4. Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore vetë kandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Komisionet e përhershme në **UniBa** janë, Komisioni i Vlerësimit të Performancës, Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë. **UniBa** rezervon të drejtën për krijimin e komisioneve të tjera të përhershme në përputhje me kërkesat e institucionit dhe legjislacionin në fuqi.
6. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve rregullohet me aktet e brendshme normative.

Neni 24

Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a) Rektori;



- b) Zëvendësrektorët;
 - c) Administratori i institucionit;
 - ç) Drejtuesit e njësive kryesore.
2. Krahas funksioneve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, Rektorati ka edhe këto funksione:
- a) Harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e bëra nga njësiti bazë dhe kryesore të institucionit si dhe ato të administratorëve.
 - b) Harton raportin e detajuar vjetor të institucionit dhe e dërgon për miratim në Senat.
 - c) Harton planin vjetor të veprimtarive akademike e kërkimore dhe ndjek zbatueshmërinë e tyre pas miratimit nga Senati.
 - ç) Harton paraprakisht planet dhe programet mësimore të njësive bazë dhe i paraqet rekomandimet përkatëse Senatit. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit.
 - d) I propozon Bordit të Administrimit përmes Administratorit projekt buxhetin një vjeçar në përputhje me strategjinë afatmesme të institucionit.
 - dh) Ushtron dhe të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara në aktet normative të **UniBa**.
3. Mbledhja e Rektoratit zhvillohet me thirrjen e Rektorit dhe kryesohet prej tij. Ajo është e vlefshme me pjesëmarrjen e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e votave të pjesëmarrësve në mbledhje.
4. Në varësi të tematikës, në mbledhjen e Rektoratit mund të ftohen marrin pjesë edhe drejtuesit e departamenteve dhe qendrave kërkimore-shkencore.

Neni 25

Dekanati

1. Dekanati në **UniBa** është organ kolegjal i Fakultetit që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet:
- a) Dekani;
 - b) Zëvendësdekanët;
 - c) Përgjegjësit e departamenteve;
 - ç) Drejtuesit e qendrave kërkimore-shkencore;
 - d) Një përfaqësues i studentëve të fakultetit përkatës, pa të drejtë vote;
 - dh) Administratori i njësisë kryesore.
2. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë.
3. Funksionimi dhe organizimi i Dekanatit rregullohet në mënyrë të detajuar në aktet normative përkatëse të **UniBa**.

Neni 26

Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta

1. Pranë **UniBa** ngrihet Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta i cili shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe në veprimtaritë e tjera të institucionit.
2. Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta i paraqet propozimet e nevojshme Rektorit lidhur me këto çështje.



3. Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta përbëhet nga 5 anëtarë përfaqësues të personelit akademik, të cilët zgjidhen nga Senati.
4. Detyrat dhe funksionimi i Këshillit përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet nga Senati.

Neni 27

Komisioni i Vlerësimit të Performancës

1. Pranë **UniBa** ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Performancës i cili shqyrton çështje që lidhen me performancën e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të punësuar në institucion.
2. Komisioni i Vlerësimit të Performancës përbëhet nga Zëvendësrektori Akademi, Zëvendësrektori për Kërkimin e Aplikuar dhe Inovacionin, Zëvendësrektori për Çështjet Studentore dhe Marrëdhëniet me Komunitetin, Administratori dhe Koordinator i Menaxhimit të Performancës.
3. Aktiviteti i Komisionit të Vlerësimit të Performancës koordinohet nga Koordinator i Menaxhimit të Performancës i cili propozohet nga Administratori dhe emërohet nga Rektori.
4. Detyrat dhe funksionimi i Komisioni i Vlerësimit të Performancës përcaktohen në aktet përkatëse normative të **UniBa**.

Neni 28

Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë

1. Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (KSSC) është komision i përhershëm i cili siguron orientim, këshillim dhe mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
2. KSSC mbështetet Njësine e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë për të përmbushur funksionet e saj lidhur me garantimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit
3. Komisioni është organ kolegjal në nivel institucional me përbërje prej jo më pak se pesë anëtarësh.
4. Përbërja e komisionit dhe detyrat përkatëse përcaktohen në rregulloren dhe aktet e tjera normative institucionale.

AUTORITETET DREJTUESE AKADEMIKE

Neni 29

Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i **UniBa**, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori duhet të mbajë titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të **UniBa** ose dhe jashtë tij.



3. Rektori propozohet dhe përzgjidhet nga administratori i shoqërisë dhe emërohet nga asambleja e ortakëve. Mandati i rektorit zgjat katër vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
4. Mandati i Rektorit mbaron edhe kur ai jep dorëheqjen për arsye personale apo shëndetësore, kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton integritetin e institucionit si dhe në rastet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Deri në emërimin e Rektorit të ri, funksionet e tij përmbushen nga Zëvendësrektori Akademik ose në mungesë të tij nga njëri prej zëvendësrektorëve të tjerë.

Neni 30

Kompetencat dhe detyrat e Rektorit

1. Rektori kryeson Rektoratin dhe është Kryetar i Senatit Akademik. Në mungesë të Rektorit disa prej këtyre funksioneve i kryen Zëvendësrektori përkatës, me urdhër dhe porosi.
2. Kompetencat dhe detyrat kryesore të Rektorit janë:
 - a) Drejton dhe përfaqëson zyrtarisht **UniBa** dhe vepron në emër të tij.
 - b) Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e Rektoratit, siguron menaxhim të frytshëm dhe kontroll të institucionit; mban përgjegjësi për zhvillimin e rregullt të procesit akademik dhe promovimin e punës së institucionit.
 - c) Garanton ekzekutimin e vendimeve të Bordit të Administrimit; harton propozime për çështjet e drejtimit në të ardhmen, synimet strategjike, politikat dhe orientimin e zhvillimit institucional, sipas planit të zhvillimit.
 - ç) Drejton, organizon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor e kërkimor.
 - d) Kryeson Senatin dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Bordin e Administrimit.
 - dh) Në emër të Senatit i propozon Bordit të Administrimit qëllime, politika dhe veprime që u shërbejnë interesave më të mira të komunitetit dhe të **UniBa**.
 - e) Pas këshillimit me Senatin Akademik i rekomandon Bordit të Administrimit:
 - i. përshkrimin e vendeve të punës dhe kriteret e konkurrimit për personelin drejtues;
 - ii. procedurat e emërimeve, me qëllim shmangien e diskriminimit dhe konfliktin e interesave;
 - iii. hartimin dhe lidhjen e kontratave pa afat.
 - ë) Në emër të Senatit i propozon Bordit të Administrimit krijimin, mbylljen ose ndryshimin e një strukture apo njësie ose të një njësie mësimore-kërkimore apo administrative.
 - f) Pas këshillimit me Senatin, i propozon këtij Bordi dhënien e çmimeve, titujve e vlerësimeve të tjera të institucionit.
 - g) Miraton ngarkesat mësimore të personelit akademik.
 - gj) Miraton strukturën akademike të vitit mësimor.
 - h) Urdhëron fillimin e procesit për vlerësimin e brendshëm në institucion dhe bën kërkesën për akreditim institucional dhe për programet e studimeve.
 - i) Miraton planet mësimore të programeve të studimit.

- j) Shfuqizon aktet e organeve dhe autoriteteve drejtuese vartëse kur ato nuk respektojnë politikat e miratuara nga Senati dhe Bordi i Administrimit dhe bien ndesh me Statutin, rregulloret e institucionit, interesat e tij dhe të komunitetit.
 - k) Emëron drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë duke përzgjedhur midis kandidaturave të paraqitura nga përgjegjësit e njësive kryesore, si dhe Zëvendësrektorët.
 - l) Nënshkruan kontratat e punës me personelin akademik dhe atë ndihmës akademik.
 - m) Nënshkruan diplomat e studentëve në përfundim të programeve të studimit.
3. Detaje të tjera lidhur me detyrat e Rektorit pasqyrohen në aktet e brendshme normative.

Neni 31

Zëvendësrektorët

1. Për funksionimin më të mirë të tij **UniBa** parashikon të ketë zëvendësrektor për çështjet akademike, zëvendësrektor për kërkimin e aplikuar dhe inovacionin dhe zëvendësrektor për çështjet studentore dhe komunitetin.
2. Kandidati për Zëvendësrektor duhet të jenë personel akademik i kategorisë “Profesor”, ose të ketë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose BE.
3. Zëvendësrektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, ata emërohen dhe shkarkohen nga Rektori. Mandati i tyre përcaktohet në aktet e brendshme normative.
4. Zëvendësrektorët, sipas rastit, ndjekin me përgjegjësi çështjet e ecursisë së procesit akademik, të kërkimit, zbatimeve dhe projekteve si dhe ato të çështjeve studentore dhe lidhjeve me komunitetin. Ata i raportojnë drejtpërsëdrejti Rektorit.
5. Detyrat konkrete të zëvendësrektorëve paraqiten hollësisht në aktet e brendshme normative.

Neni 32

Dekanët dhe drejtuesit e instituteve

1. Dekanët dhe zëvendësit e tyre emërohen dhe shkarkohen nga Rektori për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, ndërsa drejtuesit e instituteve, që plotësojnë standardet për të qenë njësi kryesore të **UniBa**, emërohen dhe shkarkohen në bazë të akteve të brendshme normative të institucionit dhe institutit përkatës.
2. Kandidati për dekan duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të UniBa ose dhe jashtë tij.
3. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i Fakultetit dhe e përfaqëson atë. Ai koordinon veprimtarinë e departamenteve dhe qendrave kërkimore-shkencore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
4. Dekanët dhe drejtuesit e instituteve i përcjellin Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tyre. Ata janë edhe anëtarë të Rektoratit.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e dekanit dhe drejtuesit të institutit rregullohen detajuar në aktet normative të brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 33



Përgjegjësit e departamenteve dhe drejtuesit e qendrave kërkimore - shkencore

1. Përgjegjësit e departamenteve dhe drejtuesit e qendrave kërkimore - shkencore janë autoritetet drejtuese akademike më të lartë të njësive bazë dhe i përfaqësojnë ato.
2. Përgjegjësit e departamenteve emërohen dhe shkarkohen nga Rektori, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, ndërsa drejtuesit e qendrave kërkimore-shkencore emërohen dhe shkarkohen në bazë të akteve të brendshme normative të institucionit dhe qendrës përkatës.
3. Ata duhet të jenë personel akademik të kategorisë “Profesor”, ose të kenë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose BE. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të emërohen edhe lektorët që mbajnë gradën shkencore “Doktor”.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të departamentit dhe drejtuesit të qendrës kërkimore - shkencore rregullohen në mënyrë detajuar në aktet normative të brendshme dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Seksioni 2**ORGANIZIMI ADMINISTRATIV****Neni 34****Bordi i Administrimit**

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i **UniBa**, i cili garanton përmbushjen e misionit të këtij institucioni, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit përbëhet nga të paktën 3 anëtarë, të emëruar për një mandat 5 vjeçar.
3. Anëtarët e Bordit të Administrimit të **UniBa** emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë BARLETI Group, nëpërmjet vendimit përkatës.
4. Shtimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit, zëvendësimi i tyre dhe largimi rregullohen në aktet e brendshme normative të Shoqërisë BARLETI Group.
5. Rektori, drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe Administratori nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen në mbledhjet e tij.

Neni 35**Funksionet e Bordit të Administrimit**

1. Bordi i Administrimit të **UniBaka** këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) me propozim të Senatit, miraton politikat dhe planin strategjik të organizimit, administrimit dhe zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - c) me propozim të Senatit, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
 - ç) me propozim të Senatit, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
 - d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit;
 - e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - f) hyn në marrëveshje me Asamblenë e Aksionarëve në lidhje me përdorimin e aseteve të zotëruara nga shoqëria;
 - g) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit;
 - gj) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
 - h) miraton paraprakisht Statutin e institucionit, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
 - i) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektori;
 - j) miraton përshkrimin e vendeve të punës dhe kriteret e konkurrimit për personelin drejtues administrativ;
 - k) miraton procedurat e emërimeve për shmangien e diskriminimit dhe konfliktin e interesave;
 - l) miraton modelin e kontratave me kohëzgjatje me afat të pacaktuar;
 - ll) shqyrton dhe miraton dhënien e çmimeve të veçanta, të titujve a vlerësimeve të ndryshme;
 - l) brenda buxhetit vjetor të miratuar, bën ndryshime dhe rregullime të domosdoshme të nivelit të pagesave të personelit akademik, të ftuar dhe të personelit administrativ.
2. Për mbarëvajtjen e punës, efektivitetin dhe operativitetin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore, Bordi i Administrimit, në mbledhje të veçanta të tij, autoritetin e këtyre çështjeve për ndjekje e zgjidhje ia delegon Rektorit.
3. Vendimet, udhëzimet, rregullat dhe kërkesat e Bordit të Administrimit i përcillen personelit akademik dhe atij administrativ nga Rektori.

Neni 36

Organizimi i Bordit të Administrimit

1. Për drejtimin e mbledhjeve, Bordi i Administrimit zgjedh midis anëtarëve Kryetarin e tij. Në mungesë të tij, këtë detyrë e kryen një anëtar, të cilit i delegohet detyra nga Kryetari.
2. Bordi i Administrimit mund të caktojë edhe një sekretar nga personeli i institucionit. Bordi i Administrimit, pas një këshillimi paraprak me Rektoren, mund të krijojë struktura ndihmëse dhe/ose komisione për çështje të veçanta dhe për kohë të caktuar.
3. Me kërkesë të Bordit të Administrimit, Rektori mund të caktohet anëtar pa të drejtë vote në këto komisione.

Neni 37

Mbledhja e Bordit të Administrimit

1. Mbledhja e Bordit të Administrimit është e vlefshme kur në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij.
2. Si rregull, Bordi i Administrimit thirret në mbledhje nga Kryetari.
3. Anëtarët e Bordit të Administrimit, përveç pjesëmarrjes me prani fizike, mund të marrin pjesë në veprimtaritë e tij dhe me mënyra të tjera, të përcaktuara për çështje konkrete.
4. Dokumentet e vendimeve firmosen nga Kryetari.

Neni 38


Administratori i institucionit

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për drejtimin dhe mirë funksionimin financiar të **UniBa**. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit për çështjet financiare dhe administrative, të menaxhimit të mjediseve, sigurisë e logjistikës, sipas përcaktimeve ligjore.
2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori e lidh kontratën e punës me Kryetarin e Bordit të Administrimit, ku palët bien dakord mbi kushtet e saj dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
4. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe informon periodikisht Senatin Akademik.
5. Administratori është pjesëtar i Rektoratit dhe, si i tillë, ndjek dhe mban përgjegjësi për çështjet që lidhen me menaxhimin financiar dhe politikat administrative të institucionit.

Neni 39

Funksionet e Administratorit të institucionit

1. Administratori i **UniBa** kryen këto funksione:
 - a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
 - b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimit e tyre;
 - c) drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij;
 - ç) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
 - d) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit, në përfundim të vitit akademik;
 - dh) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit për çështje të administrimit të përditshëm;
 - e) kujdeset për menaxhimin e mirë të mjediseve të institucionit, merr masat për sigurinë e mjediseve dhe personelit si dhe menaxhon problemet e logjistikës në institucion;
 - ë) plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.



2. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen dhe në rregulloret e institucionit.
3. Administratori i institucionit, me miratim të Bordit të Administrimit, mund të delegojë një ose më shumë kompetenca të tij tek Administratori i Deleguar.

Neni 40

Administratori i njësisë kryesore dhe funksionet e tij

1. Administratori i njësisë kryesore realizon mirë funksionimin financiar dhe administrativ të njësisë. Ai ka formimin, së paku, në fushën e drejtësisë ose ekonomisë, me përvojë pune së paku 5 vjet në këto fusha dhe emërohet nga Administratori i institucionit me përzgjedhje.
2. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij Administratorit të institucionit si dhe informon drejtuesin e njësisë kryesore për këtë veprimtari.
3. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

Neni 41

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Administratori i institucionit.
2. Sekretari i Përgjithshëm ka këto kompetenca kryesore:
 - a) koordinon proceset ndërlidhëse midis strukturës akademike dhe administrative në proceset e akreditimit, licencimit dhe riorganizimit institucional dhe të programeve të studimit;
 - b) koordinon dhe mbikëqyr ecurinë e proceseve dhe funksioneve administrative;
 - c) administron dokumentacionin e protokoll-arshivës;
3. Funksionimi dhe detyrat e tjera të Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e institucionit.

Neni 42

Administrata

1. Administrata përbëhet nga njësitë administrative që menaxhojnë të gjitha veprimtaritë mbështetëse, financiare e organizuese të institucionit.
2. Organizimi, detyrat, grupimi dhe vendosja e tyre ndjekin zhvillimet institucionale dhe, në çdo rast, përcaktohen në rregulloret e institucionit.

KREU IV

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN “BARLETI”

Neni 43

Forma e Studimeve dhe Pranimi në UniBa

1. **UniBa** ofron studime të organizuara në module dhe të shprehura në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. **UniBa** mund të ofrojë edhe programe studimi me kohë të zgjatur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Programet në **UniBa** ofrohen në gjuhën shqipe. **UniBa** rezervon të drejtën për të ofruar programe edhe në gjuhë të tjera, në përputhje me aktin e miratimit të hapjes së programit dhe legjislacionin në fuqi.
4. Pranimi i studentëve në **UniBa**, në të gjitha programet e studimit, bëhet me vendim të institucionit dhe në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukture të institucionit.
5. **UniBa** rezervon të drejtën për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera normative në institucionit.

Neni 44

Ciklet dhe Programet e Studimit

1. **UniBa** ofron:
 - a) Programe të studimeve me karakter profesional,
 - b) Programe të ciklit të parë të studimeve,
 - c) Programe të ciklit të dytë të studimeve,
 - ç) Programe të ciklit të tretë të studimeve,në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe të këtij Statuti, pas miratimit të tyre nga ana e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të këtyre programeve, lëshohen certifikatat ose diplomat përkatëse.
2. Njësitë kryesore akademike të tij mund të ofrojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë, ku shënohen institucionet dhe njësitë bashkëpunuese.
3. **UniBa** në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, mund të ofrojë programe të përbashkëta të studimeve, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë. Në të dyja rastet, në diplomat përkatëse shënohen institucionet bashkëpunuese.
4. Në vijim të studimeve universitare, institucioni ofron edhe programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës: kualifikime e specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive, ofron forma të ndryshme të mësimit informal, sikurse shkolla verore, konferenca dhe veprimtari të tjera të ngjashme. Në përfundim të këtyre programeve, ai lëshon certifikatat përkatëse.
5. **UniBa** mund të bashkëpunojë me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe të ofrojë programe studimi të një modeli të ndryshëm nga ato të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe të bëra me dije publikut, kur diplomat lëshohen nga institucioni i huaj.

Neni 45

Programet e studimit me karakter profesional

1. **UniBa** ofron programe me karakter profesional, pas arsimit të mesëm me 60 ose 120 kredite, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Këto programe organizohen për të dhënë njohuri të konsoliduara profesionale dhe aftësi praktike përkatëse.
3. Ato kanë një kohëzgjatje normale prej një ose dy viteve akademike. Në përfundim të tyre **UniBa** lëshon “Certifikatë Profesionale” ose “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimit të kryer.
4. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 46

Programet e ciklit të parë

1. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme. Ato realizohen me jo më pak se 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja e tyre normale është 3 vite akademike ose 6 semestra.
2. Në programet e ciklit të parë mund të aplikojë çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriteret e përcaktuara nga legjislacioni përkatës në fuqi.
3. **UniBa** rezervon të drejtën për të vendosur kriteret shtesë në pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto kriteret përcaktohen në rregulloret dhe aktet e tjera normative të institucionit.
4. Studentët e ciklit të parë të studimeve, diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose me punim diplome. Pragu i notës mesatare që i jep studentit të drejtën të për t'u diplomuar duke përgatitur dhe mbrojtur një temë diplome, përcaktohet në rregulloret përkatëse të **UniBa**.
5. Në përfundim të këtyre studimeve, studentit i lëshohet diplomë “Bachelor” në fushën e studimeve të kryera.

Neni 47

Programet e ciklit të dytë

1. Programet e ciklit të dytë përfshijnë programet e studimit “Master i Shkencave”, “Master Profesional” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.
2. Programet e Studimit “Master i Shkencave” japin njohuri të thelluara teorike dhe praktike dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë brenda një specialiteti. Ato realizohen në
 - a) Programe me 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje të tyre normale 2 vite akademike ose 4 semestra.
 - b) Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë me 300 dhe 360 kredite, me kohëzgjatje 5 dhe 6 vite akademike ose 10 dhe 12 semestra.
3. Kriteret e pranimit të studentëve në këto programe përcaktohen nga legjislacioni në fuqi. **UniBa** rezervon të drejtën për të vendosur kriteret shtesë në pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto kriteret përcaktohen në rregulloret dhe aktet e tjera normative të institucionit dhe shpallen përpara fillimit të çdo viti akademik.

4. Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përmbyllen me një punim diplome dhe në përfundim të këtyre programeve të studimit, studentit i lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e studimeve të kryera.
- 4/1 Studentët që aplikojnë për cikël të dytë studimi duhet të kenë përfunduar më parë studimet e ciklit të parë të një programi të licensuar dhe akredituar, në një IAL të licensuar dhe të akredituar brenda ose jashtë vendit.
5. Programet e studimit “Master Profesional” pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe i ofrojnë studentit arsimim dhe trajnim të mëtijshëm profesional. Ato realizohen me 60 ose 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatja e tyre normale është 1 ose 2 vite akademike.
6. Studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” përmbyllen me një provim përfundimtar formimi ose me një punim diplome. Në përfundim të këtyre programeve të studimit, studentit i lëshohet diplomë “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer.
7. Studentët që kanë fituar një diplomë “Master Profesional”, mund të kryejnë plotësime të studimeve në programet “Master i Shkencave”, sipas përcaktimeve që bëhen në rregulloret e programeve të studimit.

Neni 48

Programet e ciklit të tretë

1. UniBa, ofron programe të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës, si dhe ka të drejtë të ofrojë “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”. Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor.
3. Studentët që aplikojnë për cikël të tretë studimi, duhet të kenë përfunduar më parë studimet e ciklit të parë dhe të dytë, master i shkencave të një programi të licensuar dhe akredituar, në një IAL të licensuar dhe të akredituar brenda ose jashtë vendit.
4. Kriteret specifike për pranimet në programet e ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit përkatëse.

Neni 49

Kërkimi Shkencor

1. **UniBa** zhvillon veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar, studime, projekte zhvillimi dhe veprimtari të tjera krijuese dhe inovative. Bazuar në fushat kryesore të zhvillimit kombëtar, programet e ofruara dhe dokumentet strategjike të kërkimit shkencor në **UniBa**, përcaktohen edhe fushat, drejtimet dhe vëllimi i punës kërkimore-shkencore.
2. Në **UniBa** garantohet integrimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore me atë të mësimdhënies.

3. Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në **UniBa**, synon të mbështetë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit si dhe të mundësojë që personeli akademik dhe studentët të fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.
4. Departamenti, si njësi bazë e zhvillimit të punës kërkimore – shkencore, nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe organizon veprimtarinë kërkimore – shkencore si dhe garanton integritetin e veprimtarisë kërkimore-shkencore me atë të mësimdhënies.
5. Puna kërkimore – shkencore në **UniBa** do të mbështetet edhe nga ana instituteve dhe qendrave kërkimore – shkencore që mund të ngrihen. Këto struktura do të kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore, aplikimi projektesh dhe programesh të zhvillimit dhe inovacionit si dhe konsulence për të tretët.
6. Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në **UniBa**, bazohet në aktet e brendshme normative dhe legjislacionin në fuqi.

KREU V

PERSONELI I UNIVERSITETIT “BARLETI”

Neni 50

Përbërja e personelit

1. Personeli i **UniBa** përbëhet nga:
 - a) personeli akademik;
 - b) personeli ndihmës akademik;
 - c) personeli administrativ.
2. Personeli në **UniBa** mund të jetë i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar. Ai mund të punësohet me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Personeli drejtues dhe personeli akademik i brendshëm është i punësuar me angazhim me kohë të plotë. Personeli akademik i jashtëm punësohet me angazhim me kohë të pjesshme.
3. Punësimi i personelit në **UniBa** bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për arsimin dhe Kodin e Punës. Të drejtat dhe detyrimet e personelit përcaktohen në këtë Statut, në aktet e brendshme të **UniBa**, në kontratën e punës dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 51

Personeli akademik

1. Personeli akademik në **UniBa** gëzon status të veçantë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe aktet normative të **UniBa**.
2. Personeli akademik në **UniBa** përbëhet nga kategoritë: *profesor* (me titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”), *lektor* (me gradën “Doktor”) dhe *asistentë-lektor* (me kualifikimin “Master i Shkencave”), të cilët kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Personeli akademik kryen edhe detyra administrative, detyra në ndihmë të zhvillimeve të institucionit, si edhe konsultim dhe këshillim për studentët. Ngarkesa e

plotë mësimore e personelit akademik përcaktohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe të këtij statuti.

3. Personeli akademik përzgjidhet me konkurrim nga një komision vlerësimi. Kriteret e konkurrimit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Rektori. Përbërja e komisioneve të vlerësimit përcaktohet nga Rektorati. Miratimin e angazhimit të personelit e bën Rektori.
4. Personeli i kategorive profesor dhe lektor punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar; personeli i kategorisë asistent-lektor punësohet me kohëzgjatje një vjeçare.
5. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë, së paku, kualifikimin e ciklit pasardhës të atij ku ai jep mësim.
6. Personeli akademik i ftuar punësohet sipas të njëjtave kritere si më sipër; modalitetet e punësimit të tij përcaktohen në Rregulloren Akademike.
7. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur largohet nga detyra me kërkesën e tij. Mbështetur mbi nevojat e **UniBa** dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit dhe të përsëritshme, bazuar në aktet përkatëse normative.
8. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit dhe të përsëritshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe të këtij statuti.

Neni 52

Viti Akademik Sabatik

1. Personelit akademik, të kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” në **UniBa**, në respektim të nenit 63 të ligjit nr. 80/2015, i takon e drejta e vitit akademik sabatik një herë në shtatë vjet, për një periudhë kohe deri në një vit, me qëllim për të punuar për përparimin akademik.
2. Personeli akademik që kërkon të ushtrojë të drejtën e vitit sabatik, paraqet në Departament kërkesën me projektin e tij (të orientuar në veprimtari kërkimore me karakter shkencor, të aplikuar apo inovacion, në fusha të përfshira në aktivitetin e **UniBa**) si dhe periudhën gjatë së cilës planifikon të angazhohet.
3. Kërkesa i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit dhe miratimit nga ana e Departamentit dhe Dekanit, ndërsa vendimmarrja përfundimtare i takon Rektoratit.
4. Në rast të aprovimit të kërkesës për vit sabatik, midis **UniBa** dhe personelit akademik që do të ushtrojë këtë të drejtë, lidhet një marrëveshje ku rregullohen marrëdhëniet midis palëve gjatë periudhës sabatike.
5. Në përfundim të vitit akademik sabatik, punonjësi akademik paraqet në institucion raportin përfundimtar të aktivitetit të kryer.
6. Procedura e detajuar lidhur me vitin sabatik parashikohet në rregulloren e institucionit.

Neni 53

Personeli ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik në **UniBa** ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe personel ndihmës akademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor përbëhet nga ekspertët, laborantët, teknikët, personeli ndihmës, kërkuesit shkencore të qendrave instituteve të afiliuar pranë departamenteve të cilët ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit, nën drejtimin e personelit akademik. Ata kryejnë njëkohësisht edhe veprimtari të tjera në ndihmë të zhvillimeve të institucionit si edhe konsultim dhe këshillim për studentët. Personeli ndihmës akademik mund të punësohet me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit si dhe të zhvillimit të institucionit.
4. Personeli ndihmës akademik për zgjidhet me konkurrim nga një komision vlerësimi. Kriteret e konkurrit propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Përbërja e komisioneve të vlerësimit përcaktohet nga Rektorati. Miratimin e angazhimit të personelit e bën Rektori.
5. Personeli ndihmës akademik mund të punësohet me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Ky personel i nënshtrohet vlerësimit të performancës që kryhet në mënyrë periodike.

Neni 54

Personeli administrativ

1. Personeli administrativ përbëhet nga ai drejtues administrativ, punonjësit administrativë, të shërbimit dhe punonjësit e tjerë. Me konkurrim për zgjidhet vetëm personeli drejtues administrativ. Kërkesat e vendit të punës dhe kriteret e konkurrit për personelin drejtues administrativ propozohen nga Administratori dhe miratohen nga Rektorati.
2. Personeli administrativ mund të punësohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Ky personel mund të punësohet me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

KREU VI STUDENTËT

Neni 55

Statusi i studentit

1. Studenti e fiton statusin si i tillë në **UniBa** me regjistrimin e tij në institucion dhe pajisjen e tij me një numër të veçantë matrikullimi. Këtë status ai e humbet me marrjen e diplomës ose me çregjistrimin e tij nga institucioni, sipas rasteve të përcaktuara në Rregulloren Akademike.
2. Me fitimin e këtij statusi, studenti përfiton nga të drejtat që i lindin dhe merr përsipër të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Statut dhe nga rregulloret përkatëse të institucionit si dhe legjislacioni përkatës në fuqi.
3. Studenti ka të drejtë t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, bazuar në rregulloret përkatëse të institucionit si dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

4. Studenti ka të drejtë:

- a) të ndjekë të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku është regjistruar;
- b) të përdorë infrastrukturën, që **UniBa** vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai;
- c) të nënshkruajë kontratën e shërbimit me institucionin;
- d) të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së **UniBa**, në përputhje me përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë, statutin dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi;
- e) të shprehë vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në **UniBa**;
- f) të zgjedhë dhe të zgjidhet në këshilla studentorë dhe organet e tjera të institucionit ku parashikohet përfaqësimi i studentëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe statutin e **UniBa**;
- g) të organizohet në grupe me karakter social, kulturor, sportiv dhe akademik;
- h) të marrë pjesë në veprimtari artistike, kulturore, sportive e argëtuese, të organizuara nga **UniBa** jashtë procesit mësimor;
- i) të transferojë studimet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në **UniBa** dhe anasjelltas;
- j) të aplikojë dhe të përfitojë nga sistemi i bursave, në rast të përmbushjes së kriterëve;
- k) t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, bazuar në rregulloret përkatëse të institucionit si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- l) të sigurohet nga **UniBa**, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për financat.

5. Studenti ka detyrë:

- a) të njohë dhe zbatojnë rregullat në lidhje me studentët, të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit dhe legjislacionin në fuqi;
- b) të respektojë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- c) të paguajë tarifën e shkollimit si dhe tarifat e shërbimeve që aplikohen në **UniBa** bazuar në kontratën e shërbimit dhe legjislacionin në fuqi;
- d) të respektojë Kodin e Etikës dhe aktet e tjera rregullatore të **UniBa**.

6. Të drejtat dhe detyrat e tjera të studentit përshkruhen hollësisht në Rregulloren Akademike.

Neni 56

Këshillat e studentëve

- 1. Për mirë organizimin e jetës studentore, studentët në **UniBa** kanë të drejtë të organizohen në mënyrë të pavarur këshilla studentor në nivel Fakulteti, institucioni dhe në nivel kombëtar.
- 2. Këshillat e studentëve promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të **UniBa**.
- 3. Këshillat e studentëve nuk zhvillojnë veprimtari politike apo ekonomike dhe nuk mund të organizohen në struktura të tjera politike apo jo politike jashtë institucionit.



4. Këshillave të Studentëve zgjidhen me votim nga studentët çdo dy vjet. Organizimi dhe funksionimi i tyre rregullohet me aktet e brendshme normative të **UniBa** dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 57

Dokumentacioni i Procesit Mësimor

1. **UniBa** mban në formë të shkruar regjistrat e mëposhtëm të cilët shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin kundrejt tarifës përkatëse:
 - a) regjistrin themeltar të studentëve;
 - b) regjistrin e arritjeve akademike;
 - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
2. Regjistri themeltar i studentëve përbën dokumentin që vërteton regjistrimin e studentëve në **UniBa**. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër.
3. Regjistri i arritjeve akademike përbën dokumentin që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në **UniBa**, për çdo program studimi.
4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej **UniBa**. **UniBa** dokumenton tërheqjen e diplomës dhe shtojcës së diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale.
5. Të gjithë regjistrat e përmendur më sipër depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor të arkivave në fuqi, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së **UniBa**. Ato plotësohet edhe në formën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
6. Çdo institucion i arsimit të lartë duhet të plotësojë elementet e regjistrave, të përcaktuara si mësipërm në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tyre, depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e **UniBa**, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit.

Neni 58

Diplomimi i studentëve

Diplomimi i studentëve që përfundojnë studimet në **UniBa** bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Modalitetet e veçanta lidhur me provimet e formimit, mbrojtjes së diplomave, regjistrimit e dhënies së tyre parashikohen në Rregulloren Akademike.

Neni 59

Bursat për studime

UniBa rezervon të drejtën për të ofruar bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 60



Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi të licencuar dhe akredituar, kanë të drejtë të aplikojnë për një program të dytë studimi të të njëjtit cikël.
2. Kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në një program të dytë studimi, janë të njëjta me kriteret që duhet të plotësohen për t'u regjistruar për herë të parë në një program studimi.
3. Pranimet për regjistrim si program i dytë studimesh zhvillohen në fillim të çdo viti akademik dhe në afatet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.
4. Kandidatët kanë të drejtë të ndjekin vetëm një program studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
5. Procesi i njohjes së krediteve realizohet nga komisionet *ad hoc* të departamenteve që mbulojnë programet përkatëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregullat e institucionit.

Neni 61

Transferimi i studimeve dhe njësimi i periudhave të studimit

1. UniBa ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi të licensuar dhe akredituar më parë brenda tij ose nga institucione të tjera të licencuara dhe akredituara brenda ose jashtë vendit.
2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
3. Pranimet për regjistrim si transferim studimesh zhvillohen në fillim të çdo viti akademik, në përputhje me afatet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me Rregulloren e **UniBa**, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe udhëzimet përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
4. Vendimi për njohjen e krediteve të fituara nga një student që transferohet, me qëllim vazhdimin e studimeve në **UniBa**, i takon komisionit përkatës *ad hoc* të ngritur nga departamenti që ofron programin e studimit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VII

FINANCIMI DHE AUDITIMI

Neni 62

Financimi

1. **UniBa** është institucion jo publik i arsimit të lartë me vetëfinancim. Të ardhurat e tij parësore janë financimet e Shoqërisë **BARLETI Group**, në të cilat përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbimet e tjera të ligjshme.
2. **UniBaka** të drejtë të pranojë ndihma/donacione dhe të ardhura financiare nga sektori publik, sektori privat, shoqëria civile, subjektet ndërkombëtare, projektet e fituara dhe çdo burim tjetër i ligjshëm financiar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

3. **UniBapaguan** rregullisht taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve. Veprimtaria ekonomike e institucionit pasqyrohet në bilancet tremujore dhe vjetore të tij. Ai mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 63

Kontrolli dhe Auditimi

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në **UniBa** dhe njësitë përbërëse të tij, realizohen nga struktura e auditit të brendshëm të tij. Krijimi dhe funksionimi i kësaj strukture bëhet në përputhje me aktet normative të **UniBa**
2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm i institucionit realizohet nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave. Raporti i auditimit i paraqitet autoriteteve drejtuese të **UniBa** në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 64

Raportimi

1. **UniBa** paraqet çdo vit akademik, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, raport vjetor në lidhje me veprimtarinë e kryer, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, informacion për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës.
2. Afatet për raportim përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 65

Vula dhe stema

1. **UniBa** ka vulën zyrtare, ku shkruhet: **UNIVERSITETI BARLETI**, me skemë të organizuar ngjashmërisht me stemën e institucionit.
2. Stema e **UniBa** është në formë rrethore. Në hapësirën brenda dy rrethëve shkruhet **UNIVERSITETI BARLETI**; në hapësirën brenda rrethit të brendshëm është figura e Marin Barletit, poshtë të cilës, në formë harku, shkruhet **TIRANË** (bashkëlidhur).
3. Miratimi dhe ndryshimi i vulës dhe i stemës bëhet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Neni 66

Rregulloret

1. Mbështetur në këtë statut dhe me qëllim zbatimin e tij hartohen rregulloret përkatëse si dhe aktet e tjera të cituara në këtë Statut, të cilat miratohen nga Senati.
2. Aktet normative të mësipërme duhet të jenë në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 67



Publikimi

Ky Statut bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit pas miratimit të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 68**Dispozita kalimtare**

1. Ky Statut hynë menjëherë në fuqi pas miratimit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Me hyrjen në fuqi të tij shfuqizohet Statuti aktual i institucionit.
2. Aktet e tjera normative të **UniBa** mbeten në fuqi deri në shfuqizimin e tyre nga Senati i ri që do të krijohet në bazë të këtij Statuti, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
3. **UniBa**, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë statut, riorganizon strukturën e brendshme akademike dhe administrative. Deri në krijimin e strukturave të reja, strukturat ekzistuese vazhdojnë të kryejnë normalisht funksionet e tyre.
4. Procesi i riorganizimit nis menjëherë pas miratimit të këtij Statuti nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.
5. Programet e studimeve që janë duke u zbatuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti konsiderohen të licencuara dhe të akredituara në pajtim me aktet administrative të nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e tjera kompetente.
6. Çështjet e parregulluara me këtë Statut, rregullohen me rregulloret e brendshme të **UniBa** si dhe aktet e tjera normative të tij.

Miratuar me vendim të senatit akademik Nr. 52, datë 13/11/2020

Ndryshuar me vendim të senatit akademik Nr. 22, datë 14/04/2025

Ndryshuar me vendim të senatit akademik Nr. 40, datë 24/10/2025

Për senatin e universitetit "Barleti"

KRYETARI

Prof. Dr. Suzana Guxholli

